

URDHËR
Nr. 117, datë 19.2.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 23, DATË 18.1.2021, “PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE MJEKËSORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË, TË NIVELIT TË PARË EPROR, PËR VLERËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 4, pika 3, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar; të pikave 2 dhe 7, të kreut II, të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 23, datë 18.1.2021, “Për miratimin e përbërjes së komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, të nivelit të parë epror, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara”, bëhen ndryshimet si vijon:

Në pikën 2, germa “d”, Komisioni (KMCAp/KMVP) për para/tetraplegji, pas germës “iii”, shtohet germa “iii/1 Z. Bujar Cakani (Neurolog)”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**